



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr. 184, datë 17.09.2020

**PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. **Znj. Donika Prea**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Znj. Donika Prea do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, përkohësisht nga data 19.09.2020 - 18.12.2020.
3. Të njoftohen për këtë vendim Znj. Donika Prea, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETARI**  
**GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR**  
**KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR**  
**SANDËR BECI**

**ANËTAR**  
**BUJAR SHESHI**

**ANËTAR**  
**VATË STAKA**

**ANËTAR**  
**ESMERALDA KESHI**

**ZV/KRYETAR**  
**ALFRED BALLA**

**ANËTAR**  
**NURIHAN SEITI**

**ANËTAR**  
**TARTAR BAZAJ**

